



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

UP1 Numër 0803-65

29.02.2024

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.0803-65 datë 16.02.2024 dhe Propozimin PA1 nr.0803-65 datë 27.02.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.0201-1006/3 datë 28.02.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 7-të mbajtur më 28.02.2024, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, PA1 nr.08-100 datë 07.09.2023.

Arsyetim

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 6-të mbajtur më 19.02.2024, me Konkluzion ark.nr.0201-773/17 datë 19.02.2024, miratoi propozimin e mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga ana e drejtorit të Agjencisë, PA1 nr.0803-65 datë 16.02.2024 dhe inicioi procedure për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, PA1 nr.08-100 datë 07.09.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.0503-788/1 datë 16.02.2024, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë me datë 21.02.2024, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.0803-65 datë 21.02.2024, për njoftim se nëse nuk paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Megjithatë, më 27.02.2024 drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për Financa dhe Logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.0503-788/2 datë 27.02.2024, se SHTR GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, më 26.02.2024 ka kryer pagesë në shumë prej 21.223,00 (njëzet e një mijë e dyqindë e njëzet e tre) denarë, me të cilën kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio e pagoi në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.0803-65 datë 16.02.2024 dhe Propozimin PA1 nr.0803-65 datë 27.02.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.0201-1006/3 datë 28.02.2024, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 7-të mbajtur më 28.02.2024, vendosi të ndalon procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).